




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-22773/24 datë: 22.08.2024



Npi – 01/286 datë: 30.08.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d), nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; Nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe Propozimit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/899 të datës 23.08.2024; Kuvendi Komunës, pasi analizoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, Npi-01/281 dt. 28.08.2024 në seancën e mbajtur më 30.08.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi-01/189 TË DATËS 06.09.2012

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 30.08.2024, unanimisht miratoi, Vendim për ANULIMIN e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 të datës 06.09.2012, për dhënjën në shfrytëzim, sipërfaqen prej 50 (psëdhjetë) ari sipërfaqe truall për ndërtimin e objektit të Policisë së Kosovës njësia në Shtime, në ngastrën Kdastrale 1398/1; Z.K. – Shtime; Evidentuar (Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime).

II

A r s y e t i m: Anulimi i Vendimit Npi-01/189 i datës 06.09.2012, bëhet me arsyetimin se Objekti i Policisë së Kosovës – Njësia në Shtime tani është dislokuar, dhe objekti është ndërtuar në një pjesë tjetër të qytetit (Në rrugën, Tahir Sinani). Prandaj ky vendim ka për qëllim ri-destinimin e asaj sipërfaqe prej 50 ari, në zonë për ndërtimin e Objektivit për Banim të Përballueshëm, nga Ministria për Mjedis, Planifikim Hapsinor dhe Infrastrukturë.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rezhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi